

# Çfarë është një sulm Spear-Phishing




Spear phishing është një sulm kibernetik i cili synon një individ ose organizatë me qëllimin për të marrë informacione konfidenciale

**1.**



Një sulmues kibernetik identifikon si fillim një pjesë të të dhënave që dëshiron të ketë dhe më pas identifikon individin që ka këto të dhëna

**2.**



Sulmuesi hulumton mbi individin dhe i paraqitet atij si një burim i besueshëm

**3.**




Më pas sulmuesi bind viktimën e tyre të shpërndajë këto të dhënat me të dhe i përdor ato për të kryer një veprim keqdashës

# Ndryshimet midis Phishing dhe Spear Phishing




Qëllimi i tyre është i njëjtë, por spear phishing është shumë më i personalizuar për viktima të synuara.

**Phishing është i orientuar drejt sasisë,**  
që do të thotë përpiqet për të sulmuar shumë viktima në të njëjtën kohë



**Spear phishing është i orientuar drejt cilësisë,**  
që do të thotë është një përpjekje për të sulmuar një viktimë të caktuar me një mesazh të personalizuar.

# Çfarë të bëni nëse bini pre e një sulmi spear phishing



**Shkëputuni nga interneti**



**Bëni një kopje rezervë të të dhënave tuaj**



**Ndryshoni fjalëkalimin tuaj**



**Skanoni hardware-in e kompjuterit tuaj**